VENDIM
Nr. 80, datë 6.7.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" nenit 43, shkronja "c", nenit 27, nenit 58, nenit 70, pika 1 dhe nenit 71, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 47, pika 4, dhe nenit 126, pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neneve 43, pika 3, dhe 62, pika 1, shkronja "c" dhe neni 72, pika 5, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit të unifikuar të raportimit" miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 45, datë 10.6.2009, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 2, pika 3 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

"3. nenit 43, pika 3, nenit 62, pika 1, shkronja "c" dhe nenit 72, pika 5, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre"".

b) Në nenin 2, pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

"6) neneve 14 dhe 15, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar".

c) Në nenin 3, pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:

"ERRS" është sistemi elektronik raportues rregullator i cili, në zbatim të përgjegjësive ligjore të Bankës së Shqipërisë dhe kërkesave të kuadrit rregullativ mundëson raportimin "online" të SRU-së dhe të të dhënave të tjera, nga ana e subjekteve raportuese.".

d) Në nenin 5, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

"3. Formularët shoqërohen nga udhëzuesit dhe manualet përkatëse".

e) Në nenin 6, pika 1, shkronja "d" togfjalëshi *"Departamenti i Statistikave"* zëvendësohet me togfjalëshin *"Departamenti i Statistikave Financiare".*

f) Në nenin 9, pika 1 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"1. Të gjitha sistemet raportuese administrohen nga Zyra e Përpunimit të të Dhënave pranë Departamentit të Statistikave Financiare."

g) Në nenin 9, pika 2 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

"2. Procedurat e punës për administrimin dhe kontrollin e raportimeve përcaktohen me udhëzimet dhe manualet përkatëse, të cilat miratohen nga administratori, i cili ka në varësi Departamentin e Statistikave Financiare."

h) Në nenin 11, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 dhe pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

"2/1. Raportimi në formë elektronike për subjektet raportuese banka bëhet përmes ERRS-së."

"6. Subjektet raportuese të cilat raportojnë përmes sistemit ERRS, dërgojnë me shkrim pranë njësisë pritëse, listën e punonjësve të autorizuar për plotësimin, kontrollin dhe dërgimin e raportimeve. Ndryshimet në listën e punonjësve të autorizuar për raportim duhet të njoftohen pranë njësisë pritëse pranë Bankës së Shqipërisë."

i) Formularët 20–21, 24, 25, 34, 35, 36, 38/1, 31.1, 20/1, 46, 47, 33A, 33B, F1, F2, F3, F4 bashkëlidhur kësaj rregulloreje shfuqizohen dhe zëvendësohen me formularët F20-21, F37/4, F37/6, F37/5, F37/7, F37.9, F37.8, F37/3, F37/2, F37/1, F37, F34, F34.2, F35, F36.1, F36.2, F8.1, F8.2, F8.3, F8.4, F20_21 Pkon_Valutor, F61.2, F100/1, F60.1, F.33A, F.33B, F1, F2, F3, F4, bashkëlidhur këtij vendimi.

j) të miratojë formularët f22_1, f28, f29, f31.1, f33b1, f33b3, f34.1 f35.2, f4.dm, f8.dm, f7.dm, f11.dm, f12.dm, mkr_sa_tdi, mkr_sa_equ, f3.dm, f5.dm, f6.dm, f9.dm, f44, f45, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën

e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 tetor 2016.

KRYETARI

Gent Sejko